

Të nderuar,

Është nder dhe kënaqësi e veçantë t'ju ftojme në Konferencën Ndërkombëtare Rregullatore (IRC) 2026, e cila do të organizohet nga Agjencia për Komunikime Elektronike të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Konferenca do të mbahet në qytetin historik dhe piktoresk të Ohrit, më 19 dhe 20 maj 2026. Me praninë tuaj, së bashku do të kontribuojmë dhe do të shënojmë „Ditën Botërore të Telekomunikacioneve dhe Shoqërisë Informatike”, si dhe fushën e të cilës të gjithë i jemi përkushtuar – komunikimet elektronike.

Kjo konferencë do të bashkojë pjesëmarrës nga e gjithë Evropa, duke përfshirë përfaqësues qeveritarë, përfaqësues të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve, organeve rregullatore, komunitetit akademik, operatorëve, ekspertëve të industrisë dhe kompanive të tjera, si dhe personalitete të shquara nga tregu kombëtar dhe global i komunikimeve elektronike.

Konferenca, nën moton „Rregullat për të nesërmen takohen sot”, pasqyron thelbin e një periudhe transformuese, në të cilën vendimet, diskutimet dhe ekspertizat aktuale ndikojnë drejtpërdrejt në rregullat që do të rregullojnë peizazhin e ardhshëm të komunikimeve elektronike, duke formësuar në mënyrë aktive kornizën rregullatore të së ardhmes. Agjenda do të publikohet në faqen e internetit [www.aec.mk](http://www.aec.mk). Nëse jeni të interesuar të prezantoni arritjet tuaja në këto tema, jeni të mirëpritur t'i propozoni dhe t'i ndani me ne në këtë ngjarje. Paralelisht do të organizohen dy punëtori të veçanta të dedikuara për sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e konsumatorëve.

Konferenca Ndërkombëtare Rregullatore (IRC) 2026 është organizuar si një ngjarje dyditore (19–20 maj) dhe do të mbahet në hotelin „Metropol” në Ohër.

Kokteji i mirësearchjes do të organizohet më 18 maj 2026.

Ju lutemi konfirmoni pjesëmarrjen tuaj në linkun e mëposhtëm: <https://forms.office.com/e/FTCTS0c7Xu>, dhe tregoni interesin tuaj për prezantim duke dërguar titullin e tij me email në adresën [irc2026@aec.mk](mailto:irc2026@aec.mk) jo më vonë se 6 maji 2026. Të gjitha informacionet shtesë në lidhje me Konferencën Ndërkombëtare Rregullatore (IRC) 2026 mund të gjeni në linkun e mëposhtëm: <https://aec.mk/international-regulatory-conference-2026/>.

Personat kontaktues: Elizabeta Dvojakova (email: [elizabeta.dvojakova@aec.mk](mailto:elizabeta.dvojakova@aec.mk)), Valbona Osmani (email: [Valbona.h.osmani@aec.mk](mailto:Valbona.h.osmani@aec.mk)) dhe Dragica Lepavcova (email: [dragica.lepavcova@aec.mk](mailto:dragica.lepavcova@aec.mk)).

Në pritje të aplikimeve tuaja, Ju përshëndesim përzemërsisht.